

## Fjala e Sekretares së Përgjithshme të RCC-së, znj. Majlinda Bregu, në Samitin e Berlinit, më 3 nëntor 2022

*“Kur bota ngjan e madhe dhe komplekse, nuk duhet të harrojmë asnjëherë që të gjitha idetë e mëdha e patën pikënisjen e tyre diku, në një lagje të vogël.”*

Të nderuar Shkëlqesi!

Ndërsa jemi mbledhur sot këtu, për vazhdimin e shumëpritur të Samitit të Procesit të Berlinit, citimi i mësipërm, i cili i atribuohet Kancelarit **Adenauer**, kumbon fort në të gjithë Ballkanin Perëndimor (BP), një qoshe e botës kjo plot sfida, por edhe mundësi, një rajon ky i yni i lidhur ngushtësisht e në mënyrë të pandashme me Europën.

Edhe pse u menduan si pothuajse të pamundura, pas një pune të pareshtur gjatë dy vjetësh të vështirë e të mundimshëm, të trija marrëveshjet qendrore të bashkërenduara nga RCC-ja arrijnë të shohin më në fund dritën e diellit, pasi sot ato do të preken nga ata për të cilët edhe u krijuan: qytetarët tanë!

Ashtu si ndikimi i gjithandeshëm i marrëveshjes rajonale për heqjen e tarifave “roaming” dhe korridoret e gjelbra, edhe këto tri marrëveshjeve do të prekin jetën e përditshme të qytetarëve në formë të drejtpërdrejtë dhe konkrete.

Që nga shkatërrimi i murit të fundit të vizave që kishte mbetur në rajon, ai mes Kosovës\* dhe Bosnje-Hercegovinës.

E di që regjimi pa viza me Bosnje-Hercegovinën nuk është i njëjtë për Kosovën\* si regjimi pa viza me BE-në, por në të vërtetë, ky është edhe thelbi i idesë “një rajon, një treg”.

Integrim më i thellë ekonomik e pa barriera, njohje pa probleme e kualifikimeve akademike dhe profesioneve.

Të gjitha këto kontribuojnë për ndërtimin e urave, për të cilat ka ende nevojë rajoni ynë, mes vetes dhe me BE-në, një trajtim të barabartë.

Me shpresën për procedura që do ta bëjnë të mundur ratifikimin e tyre shpejt e pa vonesa, ne do të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje për këto marrëveshje, në mënyrë që të mirat që ato sjellin të shpërndahen tek qytetarët sa më shpejt që të jetë e mundur.

Shkëlqesi!

Investimi me anën e kapitalit politik dhe diplomatik nga ana e qeverive të Ballkanit Perëndimor dhe të partnerëve tanë të BE-së për përfundimin e marrëveshjeve të lëvizshmërisë, vërteton edhe një herë se kur ka vulllet ka gjithmonë një rrugë për të arritur atë që duam.

Me këtë punë si shtysë dhe inkurajim për të ardhmen, është koha që të ndjekim shembullin e Shteteve Anëtare që janë bërë pjesë e nismës së korridoreve të gjelbra, dhe të bëjmë realitet edhe uljen e tarifave “roaming” ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.

---

\* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Jam e sigurt që do të mund të tregojmë rezultate të tjera konkrete në Samitin BE-BP që do të mbahet në Tiranë në dhjetor të këtij viti.

Në këto kohë të vështira që po kalojmë, kemi nevojë jo vetëm për këto nisma, por edhe për masa të tjera për të qënë të integruar në fusha si energjia, rezistenca kibernetike, keqinformimi, etj.

Si një mekanizëm gjithëpërfshirës rajonal, RCC-ja është e gatshme të kontribuojë për mbarëvajtjen e Procesit të Berlinit, si edhe të Samiteve të ndryshme të këtij Procesi, duke ofruar dhe siguruar një nga aftësitë që mësohet më gjerësisht në çdo vend: bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

Faleminderit!